



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 19 prill 2022
Nr.ref.:RK 1980/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI148/21

Parashtrues

Fatos Dervishaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr.
39/2021, të 3 qershorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fatos Dervishaj nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 39/2021] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 3 qershorit 2021 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [Ca. nr. 858/2016] e Gjykatës së Apelit të 31 tetorit 2016, dhe Aktgjykimin [C. nr. 428/2012] e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 5 nëntorit 2015 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] dhe nenin 45 [Arsyetimi i Vendimeve] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] në lidhje me nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 18 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 18 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë.
7. Më 19 gusht 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 7 shtator 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

9. Më 31 mars 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve të rastit

10. Parashtruesi i kërkesës është duke parashtruar për herë të tretë kërkesë në Gjykatë. Më parë, ai kishte dorëzuar kërkesën KI19/17 për të cilën Gjykata me Aktvendimin e 20 shkurtit 2018, vendosi të deklarojë të njëjtën të papranueshme. Po ashtu ai kishte dorëzuar edhe kërkesën KI158/19, ku nga dosja e lëndës vërehet se kishte iniciuar një numër të madh të procedurave para autoriteteve të ndryshme publike dhe të cilat i kontestonte para Gjykatës, ku sa i përket procedurës kontestimore (kontestit të punës) e cila lidhet me kërkesën e tanishme, Gjykata nuk kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk kishte ngritur asnjë pretendim për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese sa i përket kësaj procedure dhe po ashtu procedura ende ishte duke u zhvilluar në Gjykatën e Apelit, dhe me këtë Gjykata kishte vendosur të shpallë të papranueshme në tërësinë e saj kërkesën KI158/19 përmes Aktvendimit për papranueshmëri, të 24 korrikut 2020. Vetëm faktet juridike të kërkesës KI158/19 sa i përket procedurës kontestimore ndërlidhen me kërkesën e tanishme.
11. Më 1 qershor 2007, parashtruesi i kërkesës kishte filluar punën në Kompaninë “Wurth Kosova” Sh.p.k (në tekstin e mëtejme: Wurth Kosova).
12. Më 29 dhjetor 2011, pronari i Wurth Kosova mori vendim që (i) numri i punëtorëve në ndërmarrje të zvogëlohet në shkallën prej 2/3; (ii) 20 pozita aktive të punonjësve të shuhen sipas organogramit të paraqitur në aneksin 1 të vendimit; (iii) 20 punonjës të ndërmarrjes do të largohen për shkak të shkaqeve ekonomike; dhe (iv) ndalohej punësimi i punonjësve të rinj për së paku 6 muajt e ardhshëm. Lidhur me këtë vendim punonjësit u njoftuan më 18 janar 2012.
13. Më 25 janar 2012, Wurth Kosova nëpërmjet Vendimit nr. 3506, vendosi që: (i) shkëputet kontrata me punonjësin Fatos Dervishaj më 10 prill 2012; dhe (ii) me qëllim të evitimit të shpenzimeve shtesë të ndërmarrjes, punonjësi lirohet nga detyrimi i ardhjes në punë me efekt të menjëhershëm. Përmes këtij vendimi ishte vendosur që parashtruesit të kërkesës t’i paguhet paga deri në përfundimin e kontratës.
14. Më 28 janar 2012, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Wurth Kosova, ku kishte kundërshtuar vendimin për largimin e tij nga puna.
15. Më 15 shkurt 2012, Wurth Kosova nëpërmjet Aktvendimit nr. 3534 kishte vendosur që: (i) refuzohet ankesa e parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) vendimi për shkëputjen e kontratës së punës së punonjësit i 25 janarit 2012 mbetet në fuqi, dhe kontrata shkëputet me efekt të 10 prillit 2012.

16. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë pranë Inspektoratit të Punës, ku nga i njëjti kërkoi të verifikonin ligjshmërinë e largimit nga puna të punonjësve të Wurth Kosova.
17. Më 5 mars 2012, Inspektorati i Punës pas vizitës së bërë tek Kompania Wurth Kosova nxori raportin zyrtar nëpërmjet të cilit konstatoi se punëdhënësi kishte zbatuar dispozitat ligjore në rastin e marrjes së vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Lidhur me këtë raport u njoftua Wurth Kosova dhe punëtorët të cilëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës.
18. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale), kundër Wurth Kosova, dhe nga e cila kërkoi që të anulohet vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe të kthehet në punë, si dhe t'i kompensohen pagat e humbura, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata.
19. Më 5 nëntor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), nëpërmjet Aktgjykimit [C. nr. 428/12], refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
20. Më 30 dhjetor 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes së dispozitave themelore të rregullave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
21. Më 31 tetor 2016, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktvendimit [Ca. nr. 858/2016], aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa Aktgjykimin C. nr. 428/2012 të Gjykatës Themelore e prishi dhe lëndën e kishte kthyer në të njëjtën gjykatë në riprocedurë dhe vendosje.
22. Më 20 qershor 2017, Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit [C. nr. 189/17], refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
23. Më 14 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [C. nr. 189/17] të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe pasqyrimit jo të plotë të gjendjes faktike.
24. Më 22 korrik 2020, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktgjykimit [Ac. nr. 4074/2017], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 189/17, të 31 tetorit 2016.
25. Më 23 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me kërkesë që të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe çështja të kthehet në rigjykim.

26. Më 3 qershor 2021, Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktgjykimit [Rev. nr. 39/2021], refuzoi si të pathemeltë kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës, paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] dhe 45 [Arsyetimi i Vendimeve] të KEDNJ-së.
28. Duke iu referuar pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe 45 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme është bërë shkelja e të drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj nuk ka dhënë asnjë arsyetim të pretendimeve të tij "*për normën relevante ligjore nenin 76 të Ligjit të Punës*", që sipas tij ishte kërkesë kryesore, si dhe kërkesave tjera të cilat sipas tij nuk janë shqyrtuar dhe arsyetuar fare. Më tej ai thekson se norma relevante ligjore e nenit 76 i LP-së si kërkesë kryesore, rrjedhimisht buron nga prova kryesore e cila është Vendimi i të paditurës mbi largimin nga puna të 20 punonjësve për një ditë, ndër ta edhe vetë parashtruesi i kërkesës, "*fakt i cili është fshehur dhe nuk është shqyrtuar-arsyetuar asnjëherë nga gjykata*".
29. Tutje parashtruesi i kërkesës thekson se "*Gjykata Aktgjykimin duhet ta nxjerrë sipas parimit dhe metodës, ku përshkruan në mënyrë kronologjike: çështjen, ligjin, analizën dhe vlerësimin, e secilit theksim, provave relevante veç e veç, e posaçërisht të normave juridike relevante të kërkesës kryesore dhe aksesore, si dhe pretendimeve tjera relevante, të cilat janë me rëndësi fundamentale për nxjerrjen e një Vendimi meritator nga gjykata. Pretendohet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, pothuajse 100% është përshkruar nga Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit. Derisa, norma relevante juridike Neni 76 i LP-së si kërkesë kryesore, provat relevante dhe kërkesat aksesore të paditësit, janë totalisht të fshehura, injoruar dhe përbuzura nga ky koleg*". Sipas parashtruesit gjykata nuk mund t'i injoroj kërkesat relevante të palëve, faktet relevante dhe provave relevante, e posaçërisht nuk mund t'i injoroj normat juridike relevante që janë të miratuara dhe janë në fuqi.
30. Sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme, si instancë e fundit dhe më e lartë e gjyqësorit të rregullt, duhet të kujdeset për mënjanimin e parregullsive të instancave më të ulëta, e cila duhet të vlerësojë faktet, provat, dhe kërkesat relevante të palëve, e më pas duke nxjerrë një aktgjykim të shqyrtuar dhe drejtë të arsyetuar sipas primeve të sigurisë juridike, e të harmonizuar sipas praktikës gjyqësore në Republikën e Kosovës, si dhe të bëjë administrimin e drejtë të së drejtës. Parashtruesi thekson se mosarsyetimi i një vendimi të gjykatës paraqet shkelje esenciale të të drejtave. Lidhur me këtë i referohet rasteve të Gjykatës KI72/12 dhe KI138/15.

31. Parashtruesi thekson se duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe KEDNJ-së, si palë në procedurë ka të drejtë në një vendim të arsyetuar, pasi që pretendon se Gjykata Supreme, duke mos trajtuar në mënyrë meritore kërkesat relevante të theksuara në revizion, nuk ka dhënë fare një aktgjykim të arsyetuar, të drejtë dhe të paanshëm, dhe pretendon se kjo përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si dhe shkelje të nenit 6 të dhe 45 të KEDNJ-së. Sipas parashtruesit të kërkesës: *“Pozita që ka pasur paditësi tek e paditura ishte si furnizues i ndërmarrjes, andaj një firmë tregtare siç është e paditura nuk mund të funksionojë pa pozitën e punës furnizues, ashtu që e paditura, në mënyrë që të funksionojë si duhet dhe të të shmangë pretendimet për humbjet e vazhdueshme ekonomike, është dashur të punësoj dikë në pozitën e lartcekur. Por, edhe pse kemi të bëjmë me një pozitë esenciale të vendit të punës tek e paditura, e njëjta nuk i është ofruar paditësit, gjë që përkon me shkeljet e vazhdueshme që janë bërë në këtë largim kolektiv. Prandaj, bazuar në dokumentimet e sipërcekura parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme në Aktgjykimin Rev. nr. 39/2021, duke mos cekur fare, aq më pak trajtuar e arsyetuar provat relevante, posaçërisht normën juridike relevante neni 76 i LP-së si kërkesë kryesore të paditësit, dhe kërkesat aksesore, mendohet se nuk ka pasur një proces të rregullt, të drejtë dhe të paanshëm, dhe me këtë pretendohet se ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
32. Parashtruesi i kërkesës pretendon së përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme atij i janë shkelur edhe të drejtat e garantuara me nenet 3, 49, 32 dhe 54 të Kushtetutës, por nuk shtjellon tutje se si dhe pse janë shkelur këto të drejta të garantuara me Kushtetutë.
33. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të vlerësojë se ka pasur shkelje kushtetuese të nenit 3 dhe 31 të Kushtetutës, ndërlidhur me nenin 6 dhe 45 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme; dhe (iv) të kthejë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme në rigjykim bazuar në shkeljet e gjetura.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj
- (...)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
(...)

Neni 45 Arsyetimi i vendimeve

1. Vendimet përfundimtare, si dhe ato që deklarojnë pranueshmërinë ose papranueshmërinë e kërkesave, arsyetohen.
2. Në qoftë se vendimi nuk shpreh tërësisht ose pjesërisht mendimin e njëzëshëm të gjyqtarëve, çdo gjyqtar ka të drejtë të japë një mendim të veçantë.

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

Neni 72 Procedura para ndërprerjes së Kontratës

1. Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje.
2. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit.
3. Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.
4. Punëdhënësi mund t'i ndalojë qasjen punonjësit në objektin e ndërmarrjes gjatë periudhës së njoftimit, përkatësisht para ndërprerjes së kontratës së punës.

Neni 76 Largimet kolektive nga puna

1. Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas nën-paragrafit 1.1. të paragrafit 1 të nenit 70, të këtij ligji ku përfshihen së paku 10% të të punësuarve por jo më pak se njëzet (20) të punësuar, të larguar brenda intervalit kohor prej gjashtë (6) muajsh, konsiderohet si largim kolektiv nga puna;

2. Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna, zbatohen dispozitat nga paragrafi 3 i këtij neni.

3. Para se t'i zbatojë ndryshimet e tilla, punëdhënësi i njofton paraprakisht me shkrim një (1) muaj më parë të punësuarit dhe sindikatën e të punësuarve, nëse janë të anëtarësuar në sindikatë, lidhur me ndryshimet e planifikuara dhe me pasojat e tyre, duke përfshirë: 3.1. numrin dhe kategorinë e të punësuarve që duhet të largohen nga puna; 3.2. masat që duhet të ndërmerren punëdhënësi, nëse ka të tilla, për t'i zbutur pasojat e largimit kolektiv, përfshin: 3.2.1. kufizimin ose ndërprerjen e punësimit të punëtorëve të rinj; 3.2.2. risistemimin e brendshëm të të punësuarve; 24 3.2.3. kufizimin e punës jashtë orari; 3.2.4. zvogëlimin e orëve të punës; 3.2.5. ofrimin e riaftësimit profesional; 3.2.6. të drejtat e të punësuarve të parashikuara me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ose me Kontratën e Punës.

4. Me njoftimin e bërë sipas paragrafit 3. të këtij neni, punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarve me një periudhë të paralajmërimit sipas nenit 71 të këtij ligji.

5. Punëdhënësi e njofton me shkrim Zyrën për Punësim, lidhur me largimin e të punësuarve nga puna, në mënyrë që ZP-ja të ketë mundësi t'u ofrojë ndihmë atyre për të gjetur punësim tjetër.

6. I punësuarit nuk mund të largohet nga puna, derisa punëdhënësi mos t'i ketë paguar atij një kompensim të menjëhershëm në para.

7. Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle: 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore; 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore; 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore; 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzet nëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore; dhe 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore.

8. Nëse, brenda një periudhe prej një (1) viti nga ndërprerja e kontratës së punës të të punësuarve në bazë të këtij neni, punëdhënësi ka nevojë për angazhimin e të punësuarve me kualifikime ose trajnime të njëjta, punëdhënësi nuk duhet të angazhojë persona të tjerë para se të ofrojë punën punonjësve të cilëve iu janë ndërprerë kontratat.

9. Rastet kur të punësuarit e larguar nga puna për shkak të falimentimit dhe riorganizimit të administruar nga gjykata, nuk i nënshtrohen dispozitave të këtij ligji”.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjkata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

36. Tutje, Gjykata i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj, përkatësisht me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesja e kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

37. Për sa i përket përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës legjitimohet si palë e autorizuar për parashtrimin e kërkesës, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 39/2021], të 3 qershorit 2021, pasi i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
38. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], nënregullin (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

39. Gjykata fillimisht rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson Gjykatës që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
40. Gjithnjë sipas praktikës së GjEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi e pabazuar” dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesin Praktik të GjEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë, të 30 gushtit 2019; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita, A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 225 deri në 284).
41. Në këtë kontekst, si dhe në tekstin në vijim, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e rastit konkret, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtuesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Në dritën e këtij sfondi normativ, Gjykata sjell në vëmendje se çështja thelbësore në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet me pretendimin e parashtuesit të kërkesës lidhur me mosarsyetimin e vendimit nga ana e Gjykatës Supreme. Pra, parashtuesi i kërkesës kishte ushtruar padi kundër Kompanisë Wurth Kosova për shkak të largimit të tij nga puna, me ç’rast kërkonte që të kthehet në vendin e punës dhe t’i kompensohen të ardhurat. Gjykata Themelore kishte refuzuar si të pabazuar padinë e tij. Ankesën respektive të parashtuesit të kërkesës, Gjykata e Apelit e kishte aprovuar ku kishte prishur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe lëndën e kishte rikthyer në rigjykim. Në rivendosje, Gjykata Themelore prapë kishte refuzuar padinë e parashtuesit të kërkesës. Ai përsëri përmes ankesës ishte ankuar në Gjykatën

e Apelit, ku kjo e fundit e kishte refuzuar si të pabazuar. Përfundimisht, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur kundër vendimit të Gjykatës së Apelit.

43. Gjykata edhe njëherë rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nëpërmjet Aktgjykimit të saj ia ka shkelur të drejtat e garantuara me nenet 3, 31, 32, 49, 54 të Kushtetutës dhe nenin 6 dhe 45 të KEDNJ-së. Gjykata vëren se në esencë parashtruesi i kërkesës, kërkesën e tij e ka argumentuar dhe ndërtuar në drejtim të së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

Përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetuar, respektivisht shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe 45 të KEDNJ-së

i. Parimet e përgjithshme

44. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës IF Skadiforsikring, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).
45. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës, KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
46. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin mbi të cilin ato bazohen në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tyre. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi

për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih, në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNj-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih, rastin *Morerira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues i kërkesës: *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

47. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo vlerëson se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI96/16 *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017 shih rastet e Gjykatës KI87/18 parashtrues "*IF Skadeforsikring*", Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; KI138/19 parashtrues *Ibish Raci*, cituar më lart, paragrafi 45; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138).

ii. Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

48. Në këtë kontest, Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret, çështja esenciale ndërlihet me largimin nga puna të parashtruesit të kërkesës nga ana e Kompanisë Wurth Kosova, dhe pretendimin e tij se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk është i arsyetuar mjaftueshëm. Ai, ndër të tjera, thekson se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj nuk ka dhënë asnjë arsyetim të pretendimeve të tij "*për normën relevante ligjore nenin 76 të Ligjit të Punës*" që sipas tij ishte kërkesë kryesore, si dhe kërkesave tjera të cilat sipas tij nuk janë shqyrtuar dhe arsyetuar fare. Në anën tjetër, gjykatat e rregullta pasi kanë përcaktuar që në rastin e parashtruesit të kërkesës është i aplikueshëm Ligji i Punës, kanë përcaktuar që padia e tij është e pabazuar. Kjo sepse sipas arsyetimit të gjykatave të rregullta vendimi për shkëputje nga puna është marrë konform dispozitave të nenit 70, 72, 76 të Ligjit të Punës, si dhe në pajtim me dispozitat e nenit 1, nenit 8.2, nenit 9 etj., të kontratës së punës.

49. Gjykata në vazhdim do t'u referohet pjesëve relevante të aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, që adresojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës.
50. Fillimisht, Gjykata i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, e cila me rastin e marrjes së Aktgjykimit, ndaj parashtruesit të kërkesës, ka arsyetuar se në rastin e tij janë vlerësuar të gjitha rrethanat e çështjes, të cilat kanë ndikuar në marrjen e këtij vendimi. Për më tepër, Gjykata Themelore ka arsyetuar se:

“Gjykata vlerëson se sipas Ligjit të Punës në Kosovë, marrëdhënia e punës duhet të interpretohet në tërësi si marrëdhënie kontraktuese dhe se në asnjë mënyrë nuk mund të kuptohet si çështje statusore. Në rastin konkret, mënyra e themelimit të marrëdhënies së punës me kontratë, iu ka lejuar palëve të drejtën që lirisht, por pa i cenuar dispozitat ligjore, të përcaktojnë kushtet e kontratës duke përfshirë edhe kushtet për ndërprerjen e kontratës. Me qenë se e paditura ka rezervuar të drejtën e ndërprerjes së kontratës duke e njoftuar paditësin paraprakisht, gjykata vlerëson se ky është një kusht i kontratës i ligjshëm pasi që është në harmoni me kushte ligjore që përcakton Ligji i Punës në Kosovë, e rrjedhimisht edhe ndërprerja e kontratës së punës është e ligjshme, pa marrë parasysh arsyet e ndërprerjes. Me qenë se ndërprerja e kontratës së punës ishte në pajtim me kushtet e kontratës dhe me dispozita ligjore, gjykata vlerëson se kërkesa e paditësit për kompensim të të ardhurave personale për periudhën kontestuese është e pabazuar edhe pse me propozimin e të autorizuarit të paditësit është bërë llogaritja e të ardhurave personale për paditësin me anë të ekspertizës financiare. E drejta e kompensimit të të ardhurave paditësit do t'i takonte vetëm në situatën kur ndërprerja e kontratës së punës do të ishte bërë në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe me dispozita ligjore. Duke iu referuar të gjitha këtyre gjetjeve siç janë deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, dëshmitë të dëshmitarëve dhe prova tjera të administruara gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit duhet refuzuar në tërësi për të gjitha bazat, kjo për faktin se paditësi është e vërtetë se është njoftuar me datën 18.01.2012 dhe vendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ka pranuar më datë 23.01.2012, mirëpo paditësi ka realizuar të ardhura deri më datën 10.04.2012 çka bën të nënkuptoj faktin se kontrata e punës nuk është shkëputur me efekt të menjëhershëm ku paditësi edhe për dy muaj ka realizuar paga pas vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës”.

51. Gjykata më tutje i referohet Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, e cila arsyetoi se:

“Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare [...] Përfundimin e gjykatës së shkallës së parë si në aktgjykimin e ankimuar e pranon si të rregullt edhe gjykata e shkallës së dytë, pasi kjo gjenë mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nga të cilat vërtetohet se paditësi i është shkëputur kontrata e punës ashtu siç ishte e përcaktuar me kontratë, dhe

konform dispozitave ligjore të Ligjit të Punës, të zbatuara në mënyrë të drejtë nga e paditura me rastin e nxjerrjes së vendimeve. Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.

52. Po ashtu, Gjykata vëren se edhe Gjykata Supreme kishte dhënë arsyetimin e saj, ku ndër të tjera arsyetoi:

“Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatave të shkallës së parë dhe shkallës së dytë, kur nga arsyet e sipërtheksuara, kanë vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit. Aktgjykimet e tyre nuk janë të përfshira me shkelle thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo Gjykatë, kujdeset sipas detyrës zyrtare. Gjithashtu, aktgjykimet e lartcekura, nuk janë përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, siç pretendohet nga revizioni. Kështu, me dispozitën e nenit 10.1 të Ligjit të Punës, parashihet se "Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji" siç edhe është vepruar në rastin konkret, kur në të, me vullnetin reciprok, janë paraparë të gjitha të drejtat dhe detyrat palëve~ kontraktuese dhe në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sikundër rrjedh nga provat e administruara, përkatësisht, nga shkresat e lëndës, e paditura në rastin konkret ka vepruar në harmoni të plotë me dispozitat e nenit 70, nenit 72, nenit 76 etj. të Ligjit të Punës, si dhe në pajtim me dispozitat e nenit 1, nenit 8.2, nenit 9 etj., të Kontratës së punës. Kështu, me dispozitat e lartcekura është paraparë, veç tjerash, se "Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi atëherë kur "ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative, ..." dhe se "Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje" ndërsa, "Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës ", siç edhe ka vepruar e paditura”.

53. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë adresuar dhe u janë përgjigjur të gjitha pretendimeve relevante të parashtruesit të kërkesës të ngritura përmes padisë, ankesës dhe revizionit, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke vlerësuar se gjykatat kanë pasur prova të mjaftueshme dhe bindëse që mbështesin konkluzionin e tyre përkitazi me vendimmarrjen në çështjen e parashtruesit të kërkesës.

54. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme, duke vlerësuar pretendimet e ngritura në revizion nga parashtruesi i kërkesës dhe gjetjet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore, arriti në konkluzionin se këto të fundit, pasi administruan të gjitha provat relevante, përfshirë këtu kontratën e punës, vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe raportin zyrtar të Inspektoratit të Punës, vërtetuan jashtë çdo mëdyshje se procedurat e ndjekura lidhur me largimin nga puna të parashtruesit të kërkesës ishin në harmoni me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës.

55. Po ashtu edhe sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsye lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 76 të Ligjit të Punës, Gjykata vëren se, Gjykata Supreme kishte konstatuar që e paditura, në këtë rast Wurth Kosova, kishte vepruar *“në harmoni të plotë me dispozitat e nenit 70, nenit 72, nenit 76 etj. të Ligjit të Punës, si dhe në pajtim me dispozitat e nenit 1, nenit 8.2, nenit 9 etj., të Kontratës së punës ... Në kontekstin e mësipërm, është marrë parasysh edhe fakti se e paditura në përputhje me dispozitat e sipërcekura ligjore dhe dispozitat e kontratës së punës, ka marrë vendimin për riorganizimin të dt.20.01.2012, që për shkak të vështirësive objektive ekonomike-financiare dhe me qëllimin preventiv të shmangies së falimentimit dhe mbylljes së të njëjtës, në mënyrë të detyrueshme, ka vendosur që, veç tjerash, të reduktojë stafin, në mënyrë që të mos humbasin të gjithë punëtorët dhe të mos shkëpus kontratat e punës me të gjithë punëtorët, ashtu që të mund të rimëkëmbët, të vazhdojë të funksionojë së operuari në treg dhe të ruajë pjesën e konsiderueshme të punëtorëve, gjë që, sikundër u theksua më lart, kjo është bërë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me dispozitat e kontratës së punës. Prandaj, nga këtu, kjo Gjykatë, vlerëson se nuk qëndrojnë as pretendimet e revizionit për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale”*.
56. Andaj, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë konstatuar që punëdhënësi, në këtë rast Wurth Kosova, me rastin e largimit nga puna të parashtruesit të kërkesës ka vepruar në harmoni me Ligjin e Punës dhe kontratën e punës, ku, edhe pse parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar për largimin e tij nga puna nëpërmjet Vendimit të 18 janarit 2012, atij nuk i ishte shkëputur kontrata me efekt të menjëhershëm, mirëpo ai ka vazhduar të paguhet deri në datën e skadimit të kontratës më 10 prill 2012. Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës.
57. Gjykata dëshiron të rikujtojë gjithashtu se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih, rastet e GjEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, [DHM], paragrafi 81).
58. Për sa më sipër, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlihen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në rrafshin praktik, koncepti i “drejtësisë procedurale” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat

e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI128/19, parashtrues *Artan Mala*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shkurtit 2021, paragrafi 58; dhe KI22/19, parashtrues i kërkesës *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).

59. Thënë këtë, Gjykata konsideron se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga ana e gjykatave të rregullta. Parashtruesi i kërkesës edhe më tej mund të mos jetë i kënaqur me rezultatin e gjyimit të çështjes së tij, megjithatë, pakënaqësia e tij vetvetiu nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
60. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk është arsyetuar dhe me këtë është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, duke u referuar gjithashtu në rastet e Gjykatës KI72/12 dhe KI138/15. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se përveç faktit që parashtruesi i kërkesës ka cekur dhe ka cituar rastet e Gjykatës, ai nuk ka elaboruar lidhshmërinë e tyre faktike dhe juridike, me rrethanat e rastit konkret. Gjykata thekson që arsyetimet e vendimeve të tjera gjyqësore duhet të interpretohen në kontekstin dhe në dritën e rrethanave faktike në të cilat janë nxjerrë (shih, ndër të tjera dhe në këtë kontekst, Aktgjykimin në rastin KI48/18 të 4 shkurtit 2019, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës* (LDK), paragrafi 275; rastin KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafi 80; KI115/19, parashtrues *Sadete Jusufi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 prillit 2020, paragrafi 51; KI192/20, parashtrues *Muhamed Aliu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 gushtit 2021, paragrafi 45; dhe KI56/21, parashtrues *Emrush Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2021, paragrafi 53).
61. Andaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, si të tilla, i takojnë kategorisë së tretë (iii) “pretendime të pambështetura apo të paarsyetuara”, prandaj janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

Përkritazi me pretendimet për shkelje të nenit 3, 32, 49 dhe 54 të Kushtetutës

62. Sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 3, 32, 49 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të vendosur mirë të GjEDNJ-së, Gjykata e shpallë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:

- a) kur parashtruesi/ja thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (Vendim)* nr. 4241/03, të 31 majit 2005, shih, gjithashtu, rastin *Baillard kundër Francës (Vendim)* nr. 6032/04, të 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi/ja nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, nëse autoritetet e burgut refuzojnë të paraqesin në Gjykatë dokumentet nga shkresat e lëndës së të burgosurit për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vetë Gjykata nuk vendos ndryshe.
63. Siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 3, 32, 49 dhe 54 të Kushtetutës. Mirëpo, parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet respektive, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI187/18 dhe KI 11/19, parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73, KI125/19 parashtrues: *Ismajl Bajgora*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63, dhe së fundmi rastin KI175/20, parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafët 79-82).
64. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 3, 32, 49 dhe 54, të Kushtetutës, Gjykata konkludon që kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyeshme”, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citon nenet e Kushtetutës, pa shpjeguar se si dhe pse ishin shkelur ato. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

65. Si përmbledhje, Gjykata duke u mbështetur në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk ka dëshmuar dhe nuk i ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, respektivisht me nenet e sipërcekura.

66. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar sepse këto pretendime të parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyetuara”.
67. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 31 mars 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani